VENDIM
Nr.844, datë 3.12.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME RREZATIMIN OPTIK NË VENDIN E PUNËS"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 2, shkronja "b", 39, pika 1, shkronja "b", e 44, pika 1, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", me propozimin e ministrit të Shënde-tësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet lidhur me rrezatimin optik në vendin e punës", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet në varësi të tyre për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 1 vit pas hyrjes në fuqi.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E PUNËMARRËSVE NGA RISQET LIDHUR ME RREZATIMIN OPTIK NË VENDIN E PUNËS

SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të nevojshme për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet për sigurinë dhe shëndetin, të cilat krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj rrezatimit optik gjatë punës.
2. Kjo rregullore u referohet risqeve për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve prej efekteve negative që mund të shkaktohen te sytë dhe lëkura nga ekspozimi ndaj rrezatimit optik.
3. Veprimtaritë që preken nga fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje përcaktohen me udhëzim tëpërbashkët të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për mirëqenien sociale dhe rininë, brenda 4 (katër) muajve pas miratimit të kësaj rregulloreje.

Neni 2
Përkufizime

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a)"Rrezatim optik" është çdo rrezatim elektromagnetik në brezin e gjatësive të valës ndërmjet 100 nm dhe 1 mm. Spektri i rrezatimit optik ndahet në rrezatimin ultravjollcë, rrezatimin e dukshëm dhe rrezatimin infra të kuq:

i) "rrezatimi ultravjollcë (UV)" është rrezatimi optik me gjatësi vale ndërmjet 100 nm dhe 400 nm. Zona ultravjollcë është e ndarë në UVA (315-400 nm), UVB (280-315 nm) dhe UVC (100-

[1] Ky vendim i Këshillit të Ministrave transpozon direktivën e BE-së 2006/25/KE të datës 5 prill 2006, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë, në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizikë(rrezatimi optik artificial) (Direktiva e 19-të individuale në kuptim të nenit 16 (1) të direktivës 89/391/KEE. (Nr. CELEX 32006L0025).

280 nm);

ii) "rrezatimi i dukshëm (VIS)" është rrezatimi optik me gjatësi vale ndërmjet 380 nm dhe 780 nm;

iii) "rrezatimi infra i kuq (IK)" është rrezatimi optik me gjatësi vale ndërmjet 780 nm dhe 1 mm. Zona infra e kuqe është e ndarë në IKA (780nm-1400nm), IKB (1400 nm-3000 nm) dhe IKC (3000nm-1 mm);

b) "Lazer[2]" është çdo pajisje e cila mund të prodhojë ose të amplifikojë rrezatimin elektromagnetik në brezin e gjatësisë së valës të rrezatimit optik, kryesisht nëpërmjet procesit të emetimit të stimuluar dhe të kontrolluar;

c) "Rrezatim lazer" është rrezatimi optik i prodhuar nga një lazer;

ç) "Rrezatim jokoherent" është çdo rrezatim optik përveç rrezatimit lazer;

d) "Vlerat kufi të ekspozimit (VKE)" janë kufijtë e ekspozimit ndaj rrezatimit optik, që bazohen direkt në efektet e provuara mbi shëndetin dhe mbi vlerësime biologjike. Respektimi i këtyre kufijve garanton që punëmarrësit e ekspozuar ndaj burimeve artificiale të rrezatimit optik të mbrohen nga të gjitha efektet negative të njohura mbi shëndetin;

dh) "Iradianca (E) ose densiteti i fuqisë" është fuqia e rrezatimit që bie mbi njësinë e sipërfaqes, e shprehur në vat për metër katror (W m-2);

e) "Ekspozimi radiant ose doza e ekspozimit" (H) është integrali në kohë i fluksit të rrezatimit rënës, i shprehur në xhaul për metër katror (J m−2);

ë) "radianca ose densiteti i rrezatimit (L)" është fluksi i rrezatimit ose fuqia në dalje për njësitë këndit të ngurtë/ për njësi të sipërfaqes, e shprehur në vat për metër katror për steradian (W m−2 sr−1);

f) "niveli" është kombinimi i iradiancës, ekspozimit radiant dhe radiancës ndaj së cilës është i ekspozuar një punëmarrës;

g) "nivel i rrezatimit" janë vlerat e parametrave që karakterizojnë rrezatimin optik si një agjent fizik i dëmshëm për shëndetin në mjedisin e punës, i përshkruar në shtojcën 1 (për rrezatimin optik jokoherent) dhe në shtojcën 2 (për rrezatimin lazer);

gj) "niveli i ekspozimit (NE)" është niveli i rrezatimit duke marrë parasysh masat mbrojtëse kolektive të marra për të kufizuar ekspozimin e punëmarrësve ndaj rrezatimit optik;

h) "grupet veçanërisht të ndjeshme të riskut" janë:

- gratë shtatzëna;

- të miturit;

- punëmarrësit që kanë sëmundje të konfir-muara, të cilat shkaktojnë mbindjeshmëri ndaj rrezatimit optik, ose punëmarrësit që përdorin substanca fotosensitive;

i) "Autoritetet kompetente" janë institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, si të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Vlerat kufi të ekspozimit

1. Vlerat kufi të ekspozimit për rrezatimin jokoherent, përveç atij të emetuar nga burimet natyrore të rrezatimit optik, janë përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

2. Vlerat kufi të ekspozimit për rrezatimin lazer janë përcaktuar në shtojcën II të kësaj rregulloreje.

3. Ndalohet:

a) puna e të miturve kur:

- ekziston mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimit lazer, veçanërisht të emetuar nga pajisje lazer të klasave 3B dhe 4;

- ekziston ekspozim ndaj rrezatimit artificial ultravjollcë, si ai i emetuar gjatë saldimit dhe prerjes elektrike;

---

[2]*Light amplification by stimulated emission of radiation*-amplifikimi i dritës nëpërmjet emetimit të stimuluar të rrezatimit

- pranë vendeve të punës me nxehtësi të lartë, si furrat e shkrirjes së metaleve, qelqit etj.

b) puna e grave shtatzëna kur:

- ekziston mundësia e ekspozimit ndaj rrezatimit lazer, veçanërisht të emetuar nga pajisje lazer të klasave 3B dhe 4,

- pranë vendeve të punës me nxehtësi të lartë, si furrat e shkrirjes së metaleve, qelqit etj.

c) niveli i ekspozimit ndaj rrezatimit artificial ultravjollcë për gratë shtatzëna nuk duhet të tejkalojë ¼ e vlerës kufi të ekspozimit.

SEKSIONI II
DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 4
Përcaktimi i ekspozimit dhe vlerësimi i riskut

1. Në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", punëdhënësi siguron kryerjen e një vlerësimi të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm të riskut për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve nga rrezatimi optik artificial dhe natyror. Vlerësimi i riskut identifikon masat që duhen marrë.

Në rastin e rrezatimit optik artificial, punëdhënësi identifikon burimet e tij, të cilat mund të krijojnë ekspozim të rrezikshëm në vendin e punës dhe më pas vlerëson nivelin e ekspozimit bazuar në elementet e mëposhtme:

a)matjen e nivelit të rrezatimit, siç përcaktohet në këtë rregullore;

b)të dhënat e siguruara nga prodhuesi mbi nivelin e rrezatimit të një pajisjeje të caktuar (kategoria e emetimit të pajisjes në përputhje me standardin e harmonizuar shqiptar), llamba/sistemi i llambës (grupi i riskut në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare) ose klasën e lazerit sipas standardit të harmonizuar shqiptar;

c)llogaritjen e nivelit të rrezatimit, kur është e mundur të kryhet.

Punëdhënësi vlerëson nivelet e ekspozimit, duke marrë parasysh të gjitha veprimtaritë e lidhura me skenarët e të gjitha proceseve të përdorimit të çdo burimi të veçantë të rrezatimit artificial, si vënia në punë, shërbimi, mirëmbajtja etj.

Metodat dhe aparaturat e përdorura në vlerësimin e riskut janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare.

2. Vlerësimi, matja dhe llogaritjet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, dhe vlerësimi i riskut planifikohen dhe zhvillohen nga shërbime ose persona të specializuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet e rrezatimit optik artificial jokoherent varen nga niveli i ekspozimit (NE) në lidhje me vlerën kufi të ekspozimit (VKE) të përcaktuar në përputhje me shtojcën 1 të kësaj rregulloreje dhe kryhen në intervalet e mëposhtme kohore:

a) të paktën një herë në vit, nëse $0.7 \cdot VKE < NE \leq VKE$;

b) të paktën një herë në dy vjet, nëse $0.4 \cdot VKE < NE \leq 0.7 \cdot VKE$;

Punëdhënësi mund të mos kryejë matje të tjera, nëse gjatë dy matjeve të fundit $NE \leq 0.4$ VKE, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime në vendin e punës, të cilat mund të ndikojnë në nivelin e ekspozimit.

4. Matjet dhe vlerësimi i riskut për burimet artificiale të rrezatimit lazer varen nga niveli i matur i ekspozimit (NE) në lidhje me vlerën kufi të ekspozimit (VKE) të përcaktuar në përputhje me shtojcën 2 dhe kryhen në intervalet e mëposhtme kohore:

a) të paktën një herë në vit, nëse $0.8 \cdot VKE < NE \leq VKE$;

b) të paktën një herë në dy vjet, nëse $0.4 \cdot VKE < NE \leq 0.8 \cdot VKE$;

Punëdhënësi mund të mos kryejë matje të tjera,nëse gjatë dy matjeve të fundit $NE \leq 0.4 \cdot VKE$, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime në vendin e punës, të cilat mund të ndikojnë në nivelin e ekspozimit.

5. Në vendet individuale të punës ku përdoren pajisje lazer të klasave 1, 1M, 2, 2M dhe 3R, që

përdoren në përputhje me rekomandimet e prodhuesit për operimin e tyre të sigurt, mund të mos bëhen matje të rrezatimit lazer të reflektuar ose të shpërhapur.

6. Në bazë të vlerësimit të nivelit të ekspozimit, punëdhënësi përgatit grafikun me rezultatet e vlerësimit të riskut, i cili përbëhet nga:

- specifikimi i agjentëve të rrezikshëm;
- të dhëna mbi vlerësimin e nivelit të ekspozimit;
- vendndodhja, si vendi i punës ose vendi individual i punës që është vlerësuar;
- emri i shërbimit ose personit të specializuar që ka kryer vlerësimin;
- metoda e përdorur për vlerësimin;
- niveli i përcaktuar i ekspozimit;
- interpretimi i rezultateve.

7. Punëdhënësi siguron që gjatë vlerësimit të riskut të merren parasysh elementet e mëposhtme:

a) niveli, brezi i gjatësisë së valës si dhe kohëzgjatja e ekspozimit ndaj burimeve artificiale të rrezatimit optik;

b)ekspozimi ndaj burimeve natyrore të rrezatimit optik;

c)vlerat kufi të ekspozimit, të dhëna në shtojcat 1 dhe2 të kësaj rregulloreje;

ç)çdo efekt i lidhur me shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve, që i përkasin grupeve veçanërisht të ndjeshme të riskut;

d) çdo efekt i mundshëm mbi sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, që rezulton nga ndërveprimet midis rrezatimit optik dhe substancave kimike fotosensitive në vendin e punës;

dh) çdo efekt indirekt, si verbimi i përkohshëm, shpërthimi ose zjarri;

e) ekzistenca e pajisjeve alternative të prodhuara për të zvogëluar nivelet e ekspozimit ndaj rrezatimit optik artificial;

ë) informacioni i përshtatshëm i siguruar nga mbikëqyrja shëndetësore, përfshirë informacionin e publikuar, për sa është e mundur;

f)burimet e shumëfishta të ekspozimit ndaj rrezatimit optik artificial;

g)klasifikimi i zbatuar për një pajisje lazer sipas standardeve të harmonizuara shqiptare dhe për çdo burim artificial që mund të shkaktojë dëm të ngjashëm me atë të një pajisjeje lazer të klasës 3B ose 4, ose çdo klasifikim të ngjashëm;

gj) informacioni i siguruar nga prodhuesit e burimeve të rrezatimit optik dhe pajisjeve të punës sipas standardeve të harmonizuara shqiptare.

8. Punëdhënësi siguron që vlerësimi i riskut, përfshirë të dhënat nga matjet dhe/ose llogaritjet e nivelit të ekspozimit sipas pikës, 1 të këtij neni, të dokumentohen në një formë të përshtatshme, që lejon konsultimin e tyre të mëvonshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Vlerësimi i riskut mund të përfshijë një justifikim nga punëdhënësi se natyra dhe shkalla e risqeve të lidhur me rrezatimin optik e bëjnë të panevojshëm një vlerësim të mëtejshëm të detajuar të riskut.

Punëdhënësi siguron kryerjen e rivlerësimit të riskut nëse shfaqen ndryshime të rëndësishme të vendit të punës ose të rrethanave të tjera, të cilat e bëjnë të pavlefshëm vlerësimin e riskut, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme.

Neni 5

Shmangia ose zvogëlimi i ekspozimit

1. Mbi bazën e rezultateve të vlerësimit të riskut, punëdhënësi përcakton veprimet teknike dhe organizative të nevojshme për të zvogëluar risqet që krijohen nga ekspozimi ndaj rrezatimit optik.

2. Në rastet kur vlerësimi i riskut provon se ekziston mundësia që niveli i ekspozimit të punëmarrësve të ekspozuar ndaj burimeve artificiale të rrezatimit optik të tejkalojë vlerat kufi të ekspozimit, punëdhënësi harton dhe zbaton një plan veprimi, i cili përmban masa teknike dhe/ose organizative të projektuara për të parandaluar ekspozimin që tejkalon vlerat kufi, duke

marrë parasysh në veçanti:

a)metoda të tjera të punës, që zvogëlojnë riskun nga rrezatimi optik;

b) përzgjedhjen e pajisjeve që emetojnë më pak rrezatim optik, duke marrë parasysh punën që duhet kryer;

c) masat teknike për zvogëlimin e emetimit të rrezatimit optik, përfshirë, kur është e nevojshme, përdorimin e pajisjeve për bllokim dhe/ose fikje automatike (interlocks), ekraneve mbrojtëse ose mekanizmave të ngjashëm të mbrojtjes së shëndetit;

ç)sisteme të përshtatshme të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe vendeve të punës;

d) projektin dhe strukturën e vendeve të punës dhe vendeve individuale të punës;

dh) kufizimin e kohëzgjatjes dhe nivelit të ekspozimit;

e)praninë e pajisjeve mbrojtëse individuale të përshtatshme;

ë)udhëzimet e prodhuesit lidhur me përdorimin e sigurt të pajisjeve.

3. Vendet e punës, ku punëmarrësit mund të ekspozohen ndaj niveleve të rrezatimit optik nga burime artificiale që tejkalojnë vlerat kufi të ekspozimit, tregohen nëpërmjet shenjave të përshtatshme, në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare dhe, kur është teknikisht e mundur, kufizohet aksesi në to.

4. Punëmarrësit nuk ekspozohen ndaj rrezatimit optik mbi vlerat kufi të ekspozimit. Nëse, pavarësisht masave të marra nga punëdhënësi, vlerat kufi të ekspozimit tejkalohen, punëdhënësi:

- ndërmerr veprime të menjëhershme për të zvogëluar ekspozimin nën vlerat kufi;

-identifikon arsyet e tejkalimit të vlerave kufi të ekspozimit;

- përshtat masat mbrojtëse dhe parandaluese në mënyrë që tejkalimi të mos përsëritet.

5. Kur vlerësimi i riskut tregon një risk për punëmarrësit e ekspozuar ndaj burimeve natyrore të rrezatimit optik, punëdhënësi harton dhe zbaton një plan veprimi me masa teknike dhe/ose organizative për zvogëlimin në minimum të riskut për sigurinë dhe shëndetin.

6. Punëdhënësi i përshtat masat mbrojtëse me kërkesat për punëmarrësit e grupeve të veçanta të ndjeshme ndaj riskut.

Neni 6

Informimi dhe formimi i punëmarrësve

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 12, të ligjit nr. 10237, datë 10.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", nëse punëmarrësit ekspozohen ndaj rrezatimit optik në punë, punëdhënësi u jep atyre dhe/ose përfaqësuesve të tyre informacion dhe formim të përshtatshëm e të mjaftueshëm.

2. Informimi dhe formimi përfshijnë:

a)masat e marra për zbatimin e kësaj rregulloreje;

b)vlerat kufi të ekspozimit për rrezatimin optik artificial dhe risqet potenciale të lidhura me to;

c)rezultatet e vlerësimit të riskut për vende individuale të veçanta të punës, përfshirë rezultatet e matjeve dhe/ose llogaritjeve të niveleve të ekspozimit ndaj rrezatimit optik, së bashku me një shpjegim të domethënies së tyre dhe të risqeve potenciale;

ç)mënyrën e identifikimit dhe raportimit të efekteve negative të ekspozimit mbi shëndetin;

d)rrethanat në të cilat punëmarrësve u lind e drejta për mbikëqyrje shëndetësore;

dh)praktikat e sigurta të punës për të minimizuar risqet nga ekspozimi;

e)përdorimin e duhur të pajisjeve të përshtatshme të mbrojtjes individuale.

Neni 7

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Në përputhje me nenin 13, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve, në veçanti lidhur me vlerësimin e riskut dhe masat e marra ose që duhen marrë për të shmangur ose zvogëluar ekspozimin ndaj rrezatimit optik, në përputhje me nenet 4, 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI III

DISPOZITA TË PËRZIERA

Neni 8

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Me qëllim parandalimin dhe kapjen në kohë të çdo efekti negativ për shëndetin dhe për parandalimin e risqeve afatgjata dhe çdo risku për sëmundje kronike si pasojë e rrezatimit optik, punëdhënësi siguron mbikëqyrje shëndetësore për çdo punëmarrës që ekspozohet ndaj rrezatimit optik në punë, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

2. Objekti i kontrolleve mjekësore duhet të jetë në përputhje me llojin dhe brezin e rrezatimit optik, të përcaktuar në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje.

3. Nëse një punëmarrës raporton një efekt negativ ose të papritur në shëndet ose në çdo rast kur konstatohet një nivel ekspozimi mbi vlerat kufi, punëdhënësi siguron kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të përshtatshme për punëmarrësin në fjalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen shëndetësore.

4. Ekzaminimi mjekësor kryhet në të gjitha rastet kur, si rezultat i mbikëqyrjes shëndetësore, një punëmarrës konstatohet me një sëmundje ose me pasoja negative shëndetësore, që nga mjeku i punës konsiderohen se janë rezultat i ekspozimit ndaj rrezatimit optik në punë. Mjeku i punës, kur e konsideron të nevojshme, mund të konsultohet me një specialist të fushës.

5. Në të gjitha rastet e përmendura në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, kur vlerat kufi tejkalohen ose identifikohen efekte negative në shëndet, përshirë sëmundje të ndryshme:

a) punëmarrësi informohet nga mjeku i punës mbi rezultatet që kanë lidhje me të personalisht dhe, në veçanti, informohet dhe këshillohet mbi çdo mbikëqyrje shëndetësore, të cilës duhet t'i nënshtrohet pas përfundimit të ekspozimit;

b) punëdhënësi informohet për çdo gjetje të rëndësishme të mbikëqyrjes shëndetësore, duke marrë parasysh çdo konfidencialitet mjekësor.

3. Në të gjitha rastet e përmendura në pikat 3 dhe 4, të këtij neni, punëdhënësi:

a) rishikon vlerësimin e riskut;

b) rishikon masat e parashikuara dhe të marra për të shmangur ose zvogëluar risqet;

c) merr parasysh çdo këshillë të mjekut të punës, të një personi me kualifikim të përshtatshëm ose të një autoriteti kompetent për zbatimin e masave për shmangien ose zvogëlimin e riskut;

ç) merr masa për mbikëqyrje shëndetësore të vazhduar dhe siguron rishikimin e gjendjes shëndetësore të çdo punëmarrësi tjetër që ka qenë i ekspozuar në mënyrë të ngjashme. Në raste të tilla, mjeku i punës ose autoriteti kompetent mund të propozojnë që personi i ekspozuar t'i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor.

4. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore për secilin punëmarrës dokumentohen dhe përditësohen në kartelën e shëndetit në punënë përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen shëndetësore, me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në formë të përshtatshme, që lejon shqyrtimin e tyre të mëvonshëm. Punëmarrësi, me kërkesë të tij, ka akses te të dhënat e shëndetit që kanë lidhje me të personalisht.

Neni 9

Sanksionet

Për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, vendosen sanksionet e përcaktuara në nenin 43, të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë".

SHTOJCA I

VLERAT KUFI TË EKSPOZIMIT PËR RREZATIMIN OPTIK ARTIFICIAL JOKOHERENT

Nivelet e rrezatimit ose ekspozimit ndaj rrezatimit optik, që lidhen me efektet biofizike të ekspozimit ndaj rrezatimit optik, mund të përcaktohen me formulat e mëposhtme. Formulat duhen përdorur në varësi të brezit të frekuencave të rrezatimit të emetuar nga burimi dhe rezultatet

krahasohen me vlerat kufi korresponduese të ekspozimit të treguara në tabelën 1.1. Për një burim të dhënë të rrezatimit optik mund të jenë të përdorshme më shumë se një nivel i ekspozimit dhe vlerë kufi korresponduese e ekspozimit.

Shkronjat"a" deri më "o" më poshtë i referohen rreshtave korrespondues të tabelës 1.1.

(a)	$H_{\text{eff}} = \int_0^t \int_{\lambda=180nm}^{\lambda=400nm} E_\lambda(\lambda,t) \cdot S(\lambda) \cdot d\lambda \cdot dt$	(H_{eff} është relevante vetëm në brezin 180-400 nm)
(b)	$H_{\text{UVA}} = \int_0^t \int_{\lambda=315\text{ nm}}^{\lambda=400\text{ nm}} E_\lambda(\lambda,t) \cdot d\lambda \cdot dt$	(H_{UVA} është relevante vetëm në brezin 315-400 nm)
(c), (d)	$L_B = \int_{\lambda=300\text{ nm}}^{\lambda=700\text{ nm}} L_\lambda(\lambda) \cdot B(\lambda) \cdot d\lambda$	(L_B është relevante vetëm në brezin 300-700 nm)
(e), (f)	$E_B = \int_{\lambda=300\text{ nm}}^{\lambda=700\text{ nm}} \cdot E_\lambda(\lambda) \cdot B(\lambda) \cdot d\lambda$	(E_B është relevante vetëm në gamën 300-700 nm)
(g) deri në (l)	$L_R = \int_{\lambda_1}^{\lambda_2} L_\lambda(\lambda) \cdot R(\lambda) \cdot d\lambda$	(Shih tabelën 1.1 për vlera të përshtatshme të λ1 dhe λ2)
(m), (n)	$E_{IR} = \int_{\lambda=780\text{ nm}}^{\lambda=3000\text{ nm}} E_\lambda(\lambda) \cdot d\lambda$	(E_{IR} është relevante vetëm në brezin 780-3000 nm)
(o)	$H_{\text{lëkurë}} = \int_0^t \int_{\lambda=380\text{ nm}}^{\lambda=3000\text{ nm}} E_\lambda(\lambda,t) \cdot d\lambda \cdot dt$	($H_{\text{lëkurë}}$ është relevante vetëm në brezin 380-3000 nm)

Për efekt të kësaj rregulloreje, formulat e mësipërme mund të zëvendësohen nga shprehjet e mëposhtme duke përdorur vlerat diskrete, siç përcaktohet në tabelat e mëposhtme:

(a)	$E_{\text{eff}} = \sum_{\lambda=180nm}^{\lambda=400nm} E_\lambda \cdot S(\lambda) \cdot \Delta\lambda$	dhe H_{eff} ¼ $E_{\text{eff}} \cdot \Delta t$
(b)	$E_{\text{UVA}} = \sum_{\lambda=315nm}^{\lambda=400nm} E_\lambda \cdot \Delta\lambda$	dhe H_{UVA} ¼ $E_{\text{UVA}} \cdot \Delta t$
(c), (d)	$L_B = \sum_{\lambda=300nm}^{\lambda=700nm} L_\lambda \cdot B(\lambda) \cdot \Delta\lambda$	
(e), (f)	$E_B = \sum_{\lambda=300nm}^{\lambda=700nm} E_\lambda \cdot B(\lambda) \cdot \Delta\lambda$	
(g) deri në (l)	$L_R = \sum_{\lambda_1}^{\lambda_2} L_\lambda \cdot R(\lambda) \cdot \Delta\lambda$	(Shih tabelën 1.1 për vlera të përshtatshme të λ1 dhe λ2)
(m), (n)	$E_{IR} = \sum_{\lambda=780nm}^{\lambda=3000nm} E_\lambda \cdot \Delta\lambda$	dhe $H_{\text{lëkurë}}$ ¼ $E_{\text{lëkurë}} \cdot \Delta t$
(o)	$E_{\text{lëkurë}} = \sum_{\lambda=380nm}^{\lambda=3000nm} E_\lambda \cdot \Delta\lambda$	

Shënime

Eλ (λ,t), Eλ iradianca spektrale apo densiteti spektral i fuqisë është fuqia e rrezatimit rënës për njësi të sipërfaqes, i shprehur në vat për metër katror për nanometër [Ë m−2 nm−1]; vlerat e Eλ (λ, t) dhe Eλ përftohen nga matjet ose mund të sigurohen nga prodhuesi i pajisjes;

Eeffiradianca efektive (brezi UV) është iradianca e llogaritur brenda brezit të gjatësisë së valës 180 nm deri në 400 nm, i ponderuar spektralisht sipas S (λ), e shprehur në vat për metër katrorë[m−2];

H ekspozimi në rrezatim është integrali në kohë i fluksit të rrezatimit, i shprehur në xhaul për metër katror [m−2];

H_{eff} ekspozimi radiant efektiv është ekspozimi radiant i ponderuar spektralisht sipas S (λ), i shprehur në xhaul për metër katror [m−2];

E_{UVA} fluksi total i rrezatimit (UVA) është fluksi i rrezatimit i llogaritur brenda brezit të gjatësisë së valës UVA 315 nm deri në 400 nm, e shprehur në vat për metër katror [m−2];

H_{UVA} ekspozimi radiant (UVA) është integrali në kohë dhe gjatësi vale ose shuma e iradiancës brenda brezit së gjatësisë së valës UVA nga 315 nm deri në 400 nm, i shprehur në xhaul për metër katror [m−2];

S (λ) koeficienti spektral që merr në konsideratë varësinë e efekteve shëndetësore në sy dhe lëkurë nga gjatësia e valës të rrezatimit UV, (tabela 1.2) [pa dimensione];

t, Δt koha, kohëzgjatja e ekspozimit, e shprehur në sekonda [s];

λ gjatësia e valës, e shprehur në nanometër [nm];

Δ λ gjerësia e brezit për intervalet e llogaritjes ose të matjes, e shprehur në nanometër [nm];

Lλ (λ), Lλ radianca spektrale e burimit e shprehur në vat për metër katror për steradian për nanometër [W m−2 sr −1 nm−1];

R (λ) koeficienti spektral që merr në konsideratë varësinë nga gjatësia e valës të dëmtimit termal të shkaktuar te sytë nga rrezatimi i dukshëm dhe IKA (tabela 1.3) [pa dimensione];

L_R radianca efektive (dëmtimi termal) është radianca e ponderuar spektralisht sipas R (λ), i shprehur në vat për metër katror për steradian [W m−2 sr −1];

B (λ) koeficienti spektral që merr në konsideratë varësinë e dëmtimit fotokimik të shkaktuar te sytë nga gjatësia e valës nëpërmjet rrezatimit blu (tabela 1.3) [pa dimensione];

L_B radianca efektive (drita blu) është radianca e llogaritur, e ponderuar spektralisht sipas B (λ), i shprehur në vat për metër katror për steradian [W m−2 sr −1];

E_B iradianca efektive (drita blu) është iradianca e llogaritur, e ponderuar spektralisht sipas B (λ), eshprehur në vat për metër katror [W m−2];

E_{IR} iradianca totale (dëmtim termal) është iradianca e llogaritur brenda brezit të gjatësisë së valës infra të kuqe 780 nm deri në 3000 nm, e shprehur në vat për metër katror [W m−2];

$E_{lëkurë}$ iradianca totale (VIS, IKA dhe IKB) është fluksi i rrezatimit i llogaritur brenda brezit të gjatësisë së valës së dukshme dhe infra të kuqe 380 nm deri më 3000 nm, i shprehur në vat për metër katror [W m−2];

$H_{lëkurë}$ ekspozimi radiant është integrali në kohë dhe gjatësi vale ose shuma e iradiancës brendabrezit të gjatësisë së valës së dukshme dhe infra të kuqe 380 deri më 3000 nm, i shprehur në xhaul për metër katror (J m−2);

α subtensa këndore është këndi i formuar nga një burim i dukshëm, siç shihet në një pikë në hapësirë, i shprehur në miliradian (mrad). Burimi i dukshëm është objekti real apo virtual që formon imazhin retinal më të vogël të mundshëm.

Tabela 1.1: Vlerat kufi të ekspozimit për rrezatimin optik artificial jokoherent

Indeks	Gjatësia e valës nm	Vlera kufi e ekspozimit	Njësitë	Koment	Pjesa e trupit	Rreziku
a.	180-400 (UVA, UVB dhe UVC)	H_{eff} = 30 Vlera ditore 8 orë	[J m^{-2}]		kornea e syrit konjunktiva lentja lëkura	fotokeratiti konjunktiviti kataraktogjenezis eritema elastozis kancer i lëkurës
b.	315-400 (UVA)	$H_{UVA} = 10^4$ Vlera ditore 8 orë	[J m^{-2}]		lentja e syrit	kataraktogjenezis
c.	300-700 (drita blu) *shih shënimin 1*	$L_B = \frac{10^6}{t}$ për t ≤ 10 000 s	L_B :[Ë m^{-2} sr^{-1}] t: [sekonda]	për α ≥ 11 mrad		

Indeks	Gjatësia e valës nm	Vlera kufi e ekspozimit	Njësitë	Koment	Pjesa e trupit	Rreziku
d.	300-700 (drita blu) *shih shënimin 1*	$L_B = 100$ për t > 10 000 s	[W m^{-2} sr^{-1}]		retina e syrit	fotoretinit
e.	300-700 (drita blu) *shih shënimin 1*	$E_B = \frac{100}{t}$ për t ≤ 10 000 s	E_B: [W m^{-2}] t: [sekonda]	për α < 11 mrad *shih shënimin 2*		
f.	300-700 (drita blu) *shih shënimin 1*	$E_B = 0,01$ t >10 000 s	[W m^{-2}]			
g.	380-1 400 (VIS dhe IKA)	$L_R = \frac{2,8*10^7}{C_\alpha}$ për t >10 s	[Wm^{-2} sr^{-1}]	C_α = 1,7 for α ≤ 1,7 mrad C_α = α për 1,7 ≤ α ≤ 100 mrad C_α = 100 për α > 100 mrad λ_1= 380; λ_2= 1400	retina e syrit	djegie e retinës
h.	380-1 400 (VIS dhe IKA)	$L_R = \frac{5*10^7}{C_\alpha * t^{0.25}}$ për 10 μs ≤ t ≤ 10 s	L_R:[W m^{-2} sr^{-1}] t: [sekonda]			
i.	380-1 400 (VIS dhe IKA)	$L_R = \frac{8,89*10^8}{C_\alpha}$ për t <10 μs	[W m^{-2} sr^{-1}]			
